

Ditari Natyres

"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENiOR-A
"Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"
Nr. 15 Viti i dytë i botimit Gusht 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Në perlën natyrore të Sazan – Karaburunit
- Nga takimi i OJF-ve me Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit
- Ekspozita "Parku në lapsin tim"
- Dita e Liqenit të Shkodrës
- Trainim i mësuesve mbi natyrën dhe biodiversitetin
- Eficienca e energjisë në shkollat fillore në Tiranë
- Njoftime

Në perlën natyrore të Sazan-Karaburunit


Vlorë 11 Korrik 2014 - Në kuadër të projektit të WWF "Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut-Shqipëri" i cili financohet nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet në gjendje

kritike (Critical Ecosystem Partnership Fund) dhe është pjesë e një nisme rajonale (SEA-Med) që zbatohet në 8 Zona të Mbrojtura Detare, të Libisë, Tunizisë, Turqisë, Kroacisë, Algjerisë dhe Shqipërisë, u zhvillua një "Press Trip" me përfaqësues të medias shqiptare në Zonën e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan.

Marrë nga ATSH - Lundrimi në hapësirën e gjirit detar të Vlorës edhe në një mot të papërshtatshëm dhe në kushte aspak të favorshme detare, është mjaft i këndshëm.

Kjo jep mundësinë të njohësh dhe të prekësh nga afër, ato bukuri natyrore që për arsye të ndryshme kanë qenë "tabu" dhe për një pjesë të madhe të qytetarëve, vazhdojnë të mbeten të tilla.

Uji i kthjellët dhe ajo natyrë tërësisht e virgjër, të krijojnë ndjesinë se ndodhesh diku, larg, në një vend ku imagjinata të çon rrallë. Pas një deti me dallgë duhet të përballesh me një të papritur të jashtëzakonshme, me një plazh ku uji pothuajse fle, ndanë një bregu me guralecë një formësh, të bardhë e të butë. Nëse nuk do të jetë ajo ngrehinë me strukturë të lehtë druri dhe *Vijon në faqe 2*



Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Vijon nga faqe 1 ato çadra të vendosura në mënyrë uniforme në atë plazh të jashtëzakonshëm, njeriut i duket sikur zbret në antikitet.

Gjiri i vogël detar i Shën Vasilit, ishte një nga destinacionet e një lundrimi 5-6 orësh që organizoi Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)



dhe Bashkia e Orikumit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, në hapësirën detare të gjirit të Vlorës, me një grup gazetarësh të mediave të shkruara dhe atyre vizive të vendit. Ky lundrim u realizua me anijen turistike me një emër paksa ekzotik “Regina Blu”, pjesë e dimensionit të shërbimeve që ofron kompleksi turistik “Regina”.

Duke synuar të promovojnë vlerat e kësaj hapësire natyrore, organizatorët mendojnë se kjo është edhe një nga mënyrat efektive për t’i paraprirë pritshmërive në këtë zonë, për zhvillimin e turizmit. Kjo edhe për faktin se, tashmë, hapësira detare në fjalë, përballet edhe me risqe që mund të çojnë në deformimin e vlerave të saj. Prandaj dhe lundrimi në hapësirën detare të gjirit të Vlorës, i tejkaloi dimensionet e një shetitjeje të zakonshme, apo të një njohjeje të thjeshtë të bukurive që ka skalitur natyra.

Parku Detar Karaburun-Sazan, një Zonë e Mbrojtur. Parku Detar Karaburun-Sazan (PDKS), është shpallur si i tillë në vitin 2010, me vendim të Këshillit të Ministrave. Drejtori i Institutit të Ruajtjes së Natyrës në Shqipëri, (INCA) Zamir Dedej, thotë për ATSH-në se, ai është parku i vetëm në Shqipëri me këtë status. Sipërfaqja detare totale e zonës është 12570 ha, ku përfshihen sipërfaqja detare përreth gadishullit të Karaburunit dhe ajo përreth ishullit të Sazanit, respektivisht 9.848 dhe 2.721 ha.

Parku Detar karakterizohet nga një shumëllojshmëri e jashtëzakonshme habitatesh, shpatesh nënujore, shpellash, kepesesh, plazhesh të vogla. Në këtë hapësirë, janë të

pranishme rreth 36 specie me rëndësi kombëtare, mes të cilave bari i detit, sfungjerë, knidarë, moluskë, krustace, peshq, reptilë dhe gjitarë detarë. Po ashtu, në zonë ka edhe shumë atraksione arkeologjike të periudhave të antikitetit grek, romak, të mesjetës dhe apokës moderne, të shtrira në bregdet dhe nën ujë.

“Presioni” mbi këtë park, rritet në vazhdimësi. Dedej thotë se, me zhvillimin e ri urban të qytetit të Orikumit, presioni ndaj Parkut Detar Karaburun-Sazan, po shtohet në vazhdimësi. Kjo reflektohet në ndërtimet pa leje, në shfaqjen e vatrave të zjarrit, peshkimit ilegal, zhytjet pa leje dhe grabitjen e resurseve nënujore. “Moratoriumi i Mjeteve Lundruese, pengoi në një farë mënyre edhe lëvizjen e pakontrolluar të mjeteve detare në këtë zonë dhe njëkohësisht edhe aktivitetet e paligjshme”, shprehet Dedej. Sipas tij, dukuritë negative në tokë, veçanërisht në Gadishullin e Karaburunit, është më i dukshëm dhe lidhet kryesisht me zjarret e përvitshme për hapjen e kullotave, çka ndikon në dëmtimin e bimësisë së zonës. Gjithsesi, sipas tij, aktualisht në këtë zonë po zbatohen dy projekte që mbështeten nga Ministria e Mjedisit dhe Bashkia

Orikum dhe që synojnë ruajtjen dhe ridimensionimin e vlerave të saj, duke i dhënë prioritet zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.

Prioritet, zhvillimi i turizmit

Projekti, që është një nismë e Ministrisë së Mjedisit dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve

të Bashkuara (UNDP) me fonde të Fondit Botëror të Mjedisit (GEF), ka si synim mbrojtjen e biodiversitetit bregdetar dhe detar të Shqipërisë. “Ai parashikon përmirësimin e mbulimit dhe efektivitetit të menaxhimit të rrjetit të zonave detare dhe bregdetare të mbrojtura të Shqipërisë, si një element plotësues thelbësor në rrjetin e saj të Zonave të Mbrojtura”, shprehet për ATSH-në, Zamir Dedej.

Sipas tij, rezultatet kryesore të projektit kanë të bëjnë me përmirësimin e përfaqësimit të zonave



Vijon nga faqe 2

detare dhe bregdetare të mbrojtura dhe kuadrin e përmirësuar të menaxhimit të tyre, forcimin e strukturave institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve.

Në bashkëpunim me qeverisjen vendore dhe atë qendrore janë realizuar vendosja e vrojtuesve, pajisja me mjetete e vëzhgimit dhe ato të kontrollit, si GPS dhe teleskopë etj. Projekti është pjesë e një iniciative rajonale e udhëhequr nga Zyra e Programit për Mesdheun të Fondit Botëror për Jetën e Egër, i përqëndruar në zona të ndryshme të mbrojtura detare të Mesdheut, si në Libi, Tunizi, Turqi, Kroaci, Algjeri dhe Shqipëri, që zbatohet nga INCA. “Projekti ka si synim zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, si sektori më i rëndësishëm për zhvillimin dhe financimin e Zonave të Mbrojtura, si dhe gjenerimin e të ardhurave për komunitetin lokal, që përbën njëkohësisht edhe një mundësi punësimi dhe burim të ardhurash kundrejt shërbimeve turistike që ofrohen”, shprehet Dedej. Ai sqaron se, aktualisht Parku Detar Karaburun Sazan është i vetmi në Shqipëri, por në të ardhmen do të synohet që këtë status ta përfitojnë edhe hapësira të tjera natyrore.

Gjiri i Shën Vasilit, një perlë e natyrës

Në gjirin e vogël detar të Shën Vasilit, që ndodhet në pjesën e brendshme të gadishullit të Karaburunit, në faqen veriore të tij, natyra është treguar e pakursyer. Plazhi i virgjër dhe gjelbërimi kryesisht i ulët, përfaqësojnë një raport vlerash natyrore të pakrahasueshme, ku të krijohet edhe ndjesia e ekzotizmit, por një ekzotizëm mesdhetar, madje... tipik shqiptar...(!) Plazhi me gurë të imët, ka nisur të frekuentohet nga qytetarë të shumtë, ashtu si edhe disa hapësira të tjera në këtë gadishull. Një strukturë e lehtë druri, bar restorant, disa aksesore të tjerë dhe çadrat e thurrura, përbëjnë edhe bazën infrastrukture të shërbimit. Ndërkohë, operatorë të ndryshëm ofrojnë shërbimin e transportit me mjete lundruese, si skafe komodë. Anija turistike “Regina Blu”, e vetmja e këtij lloji në Shqipëri, ofron veç transportit edhe mundësi të tjera, ku përfshihet edhe ushqimi me bazë prodhimet e detit.

Pas një dite të këndshme në këtë perlë të natyrës, pushuesit kthehen në Vlorë.

Nga takimi i OJF-ve me Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit

Tiranë, 16 Korrik 2014 - Shoqëria civile u takua më 16 Korrik me parlamentarët mbi çështjet emergjente të sektorit të ujit.

Në këtë takim të organizuar me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit, merrnin pjesë përveç deputetëve të të gjitha forcave politike dhe përfaqësues të Kryeministrit, Sekretariatit Teknik për ujin dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Z. Ylli Manjani.

Në takim u mbajt një qëndrim i shoqërisë civile dhe u dorëzua letra e pozicionimit për sektorin e ujit.

Fjala e mbajtur në Komision

I nderuar Z. Shalsi

Të nderuar zonja dhe zotërinj, deputetë të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit. Duke ju falenderuar për kohën dhe mundësinë për t’iu drejtuar sot lidhur me çështjet e adiministrimit të ujit në Shqipëri.



Ne vijmë sot me organizim të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) në Shqipëri Z. Mihallaq Qirjo dhe Z.

Eduart Cani së bashku me kolegët Xhemal Mato, Zana Vokopola, Ermelinda Mahmutaj dhe Zamir Dedej me besimin se shprehim qëndrimin e më shumë se 40 organizatave aktive në sektorin e mjedisit dhe të më shumë se 250 grave dhe burrave nga 6 basenet lumore të Shqipërisë, të cilët na kanë përkrahur të përcjellim tek ju opinioin dhe këndvështrimin e tyre në sektorin e ujit.

Ne vijmë në fund të një rrugëtimi prej afro 6 muajsh në të gjitha basenet lumore, ku jemi takuar me profesionistë të ndryshëm dhe kemi mbërritur në përfundimet e mëposhtme, të cilat përmbledhin dhjetra çështje e rekomandime, të cilat më vete janë shkruar në një letër pozicionimi, për t’iu përcjellë zyrtarisht pranë jush dhe 7 institucioneve në nivel të lartë në vend. Kësisoj, ne kemi arritur në përfundimin se:

1. Në nivel të kuadrit ligjor

Vijon në faqe 4

Faqe 3

Vijon nga faqe 3

1.1. Kuadri ligjor mbetet paharmonizuar (burime ujore, energji, ujitje, ujësjellës), e nuk garanton balancë në sektor, nuk qartëson detyrat, kompetencat dhe mardhëniet institucionale;

1.2. Ka mungesë totale të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Planeve Hapsinore, në rregullimin e ndërhyrjeve në burimet ujore.

2. Në nivel institucional

2.1. Ka një paqartësi institucionale, mungesë koordinimit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe veçanërisht në nivel baseni lumor mbi mënyrën e menaxhimit të ujit në natyrë dhe atij që përdoret për qëllime ekonomike dhe jetese;

2.2. Këshillat e Baseneve Ujore, të cilët duhet të jenë gardianët e balancës ujore, janë ose në pafuqi ose në padijeni të funksioneve të gjera që ka administrimi i basenit;

3. Në nivel ndërhyrjesh investimesh

3.1. Ka investime të panumurta në barriera, marrje zhavorresh, ndërtim rrugësh, hidrocentralesh dhe veçanërisht hidrocentralesh, digash e sisteme marrje, të cilat në pothuaj të gjitha rastet janë në shkelje të disa ligjeve dhe në raste të tjera nuk kanë marrë parasysh dëmin e rëndë që i shkaktohet trupës ujore në tërësi;

3.2. Ka mbishfrytëzim dhe keqshfrytëzim të burimeve ujore për prodhim energjie dhe është rreziku që i kanoset botës së gjallë dhe drejtpërdrejt banorëve të shumë zonave në Shqipëri;

3.3. Shfrytëzimi pa kriter i ujit nga individët dhe bizneset. Pothuaj mungesë totale e përgjegjësisë sociale dhe mjedisiore të bizneseve që përdorin ujin.

E gjitha kjo ka filluar të japë efekte e veta në:

1. Ndotje të lartë të baseneve ujore dhe veçanërisht atyre nëntokësore;

2. Rënie të sasisë ujit e për pasojë mungesës së theksuar ujit për pije;

3. Rritjen e stresit tek disa komunitete në Shqipëri, për shkak të devijimit të ujit, të cilat kanë filluar të shfaqen dhe me protesta;

4. Degradim të sistemeve ujëtare në të gjithë vendin, uljen e potencialit bujqësor;

5. Degradimin e potencialit turistik të vendit nga mungesa e sasisë së ujit për zonat bregdetare dhe funksionimi i dobët i sistemeve të trajtimit të ujit;

6. Eficiencë e dobët deri në mungesë të principeve minimale të menaxhimit të ujit për përdorim jetik;

7. E gjithë kjo po shkakton kosto të shtuara nga keqpërdorimi dhe humbja e burimeve, të cilat po i postohen të ardhmes, fëmijëve të këtij vendi. Përveç sugjerimeve të tjera të paraqitura në letërën e pozicionimit ne propozojmë që:


1. Uji duhet të menaxhohet “nga një dorë” e vetme. Ngritja e një Agjencie për Menaxhimin e Burimeve Ujore mund të sjellë në një menaxhim më të qartë në ujin si burim natyror dhe ujin si e mirë publike;

2. Përgjegjshmëria dhe sjellja e biznesit duhet fuqizuar më tej. Të gjitha industritë që përdorin ujin duhet të sigurojnë përdorim eficient të tij dhe trajtim përfundimtar të ujërave të përdorur dhe rehabilitim të burimit sa herë është e kërkuar dhe e mundur;

3. Ndalimin e investimeve në vepra të mëdha si hidrocentralet deri në përgatitjen e VSM dhe sigurimit të balancës ujore, kadastrës dhe strategjisë së ujit.

Ekspozita “Parku në lapsin tim”

Tiranë - Në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar hapi dyert ekspozita me piktura e vizatime të fëmijëve të shkollave nga zona e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Subjekti i këtyre pikturave ishin vlerat e Parkut. Kjo ekspozitë u organizua në kuadër të "Projekti për Konservimin dhe Përdorimin e Qëndrueshëm të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta me Pjesëmarrjen e Qeverisjes Lokale




dhe Palëve të Interesuara" mbështetur nga Agjensia Japoneze për Zhvillim, JICA. Që nga viti 2013, dhjetë shkolla nga zona e Parkut Kombëtar

Divjakë-Karavasta kanë zhvilluar konkursin e pikturave për natyrën. Me shumë se 1,000 punime janë realizuar nga nxënësit e shkollave nga të cilat 300 punime janë përzgjedhur për tu ekspozuar. Një ekspozitë e tillë u organizua edhe në Divjakë në Ditën Botërore të Mjedisit.

Dita e Liqenit të Shkodrës

Shkodër - Në kuadër të projektit “Ruajta e vlerave natyrore dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm në mjediset ujore”, përmes rrjetit SENIOR-A dhe me mbështetjen



e REC Shqipëri, Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës, me rastin e Ditës së Liqenit të Shkodrës organizoi aktivitetin: Foto ekspozitë “Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ujore” dhe Panairin e produkteve artizanale.

Foto-ekspozita dhe Panairi i produkteve artizanale si pjesë e aktiviteteve kishte si qëllim promovimin e vlerave natyrore, turistike, ekonomike dhe kulturore të këtij rajon. Ekspozita u zhvillua në mjedisin e Grand Hotel Europa në Shkodër me foto të bëra nga nxënësit dhe studentët e

fakulteteve të Biologjisë dhe Turizmit në Universitetin e Shkodrës duke konfirmuar angazhimin e të rinjve në iniciativa të rëndësishme. Në Ekspozitë u prezantuan mbi 70 foto të cilat u përzgjidhën mes 200 fotove të mbledhura nga studentet. Fotoekspozita mirëpriti rreth 140 vizitorë. Atë e vizituan edhe përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, përfaqësues të autoriteteve vendore, të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore, shoqata mjedisore, pedagog të Universitetit Luigj



Gurakuqi, studentë, miq dhe koleg. Eventi u shoqërua nga një koncert i shkurtër muzikor për liqenin e Shkodrës.



Trainim i mësuesve mbi natyrën dhe biodiversitetin

Për 4 ditë rresht, 16-19 Korrik 2014 Milieukontakt Shqipëri zhvilloi trajnimin për mësuesit e zonës Kastrat, Shkrel, Reç e Koplik mbi natyrën dhe biodiversitetin.

Trajnimi u zhvillua në kuadër të projektit Edukimi për Natyrën: Rrugë drejt një familje më të fortë e më të bashkuar (E2N), financuar nga



programi i Zhvillimit të Rajonit Verior (RDP) dhe zbatuar nga Komuna Kastrat dhe Milieukontakt Shqipëri.

Trajnimi synonte dhënien e njohurive dhe aftësimin e 12 mësuesve lokal në tema si natyralizmi, uji, energjia, mbetjet e gjurma ekologjike. Cikli i të mësuarit për të rritur dhe metoda Fëmija për Fëmijën ishte metodologjia e aplikuar që ndihmoi jo vetëm në përfshirjen dhe aktivizimin maksimal të mësuesve por dhe në hartimin hap pas hapi të programeve mujore dhe javore, apo

identifikimin e mjeteve të nevojshme për praktikimin e orëve. Po ashtu një vëmendje të vecantë ju kushtua edhe zbatimit të praktikave ekologjike në kamp si psh: mbledhja e ujit të shirave, ndarja e mbetjeve, serra me bimë të zones, vendosja e paneleve diellore, etj. Ekspertët u shprehën të kënaqur për ecurinë e trajnimit, dëshirën e pjesëmarrësve për të nxënë koncepte dhe adaptuar ndaj metodologjisë. Aftësitë profesionale të mësuesve lokal



gërshetuar me teknikat e marra dhe programet që do të zhvillohen do të jenë kyçi i suksesit dhe do të vendosin në baza të shëndosha ecurinë e

eko-kampit në të ardhmen. Pjesëmarrëset theksuan se ky projekt është mjaft i nevojshëm dhe i domosdoshëm për zhvillimin e zonës, aktivizimin social të fëmijëve dhe zhvillimin e turizmit në përgjithësi. Hapja e eko-kampit

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5 funksional përgjatë gjithë vitit është iniciativa e parë që aplikohet në Shqipëri.

Partnerë shumë i rëndësishëm në këtë training ishte dhe Zyra Rajonale e Arsimit për Malësinë e Madhe e cila ndihmoi në përzgjedhjen e mësuesve, identifikimin e tematikave por edhe në angazhimin për ta prezantuar eko-kampin tek të gjitha shkollat e Malësisë së Madhe si një qendër edukimi dhe praktikimi të zhvillimit të qëndrueshëm.

Trainimi u finalizua me çertifikimin e mësuesve që do të transmetojnë njohuri dhe luajnë së bashku me nxënësit e moshës 9-14 vjeç gjatë muajve gusht e shtator në Eko Kamp.

Për më shumë informacion mbi projektin mund të vizitoni: www.milieukontakt.org www.facebook.com/Milieukontakt.AL

Elva SHALA

Milieukontakt Shqipëri

Efienca e energjisë në shkollat fillore në Tiranë

Efienca e nergjisë në shkolla, kjo është nisma e ndërmarrë së fundmi nga “Milieukontakt Albania” e cila në kuadër të projekteve të saj është nismëtare edhe e një fushate të gjatë edukimi dhe ndërgjegjësimi përsa i përket kursimit të energjisë dhe përdorimit të saj në mënyrë sa më efiente.

Fushata e ndërgjegjësimit ka filluar një vit më parë ku rreth 250-300 nxënës nga pesë shkolla fillore në Tiranë ju dhanë disa orë mësimi mbi Efiençën e Energjisë.

Këtë vit Milieukontakt ishte prezente në tre shkolla të tjera në të cilat përveç ndërgjegjësimit të nxënësve për rëndësinë që ka efienca energjisë, ndërmori dhe investime konkrete për të ndryshuar llambat e thjeshta inkadeshente të shkollave me llamba LED.

Shkollat e përzgjedhura ishin shkollat “4 Dëshmoret”, “Androkli Kostallari” dhe shkolla “Xhezmi Delli”. Rreth 350-400 nxënës nga të treja shkollat u trajnuan në lidhje me masat që duhen ndërmarrë mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin sa më efient të saj.

Përveç orëve mësimore që u zhvilluan, Milieukontakt punoi së bashku me një grup nxënësish nënkujdesin e një eksperti energjie për të hartuar një raport auditimi energjie për secilën nga shkollat. Në përfundim nxënësit dolën me rekomandime e masa që duhen marrë për të përmirësuar sistemin e energjisë në ambjentet e shkollës. Përmes këtij procesi nxënësit mësuuan edhe se si bëhet

auditimi i një ndërtese. Raporti për veç të tjerave evidentoi se në shkolla të ngjashme në Botë ndriçimi zë 18% të kostos dhe në Shqipëri 30% të saj. Një tjetër rekomandim i nevojshëm ishte instalimi i një sistemi ngrohje qëndrore për shkollat i cili do të jetë i nevojshëm për periudhën e dimrit.

Gjithashtu këto 3 shkolla ishin të ndriçuara nga llamba inkadeshente dhe neonë tepër të amortizuar. Çelsat dhe prizat të shkollës gjithashtu nuk ishin në gjendje të mirë. Milieukontakt mundësoi përmisimin dhe ndërrimin e rreth 300 llambave LED në ambjentet e këtyre shkollave duke i dhënë rëndësi jo vetëm ndriçimit por dhe instalimit të tyre së bashku me plafoniera për të pasur dhe një impakt visual sa më të këndshëm për fëmijët. Gjithashtu u rregulluan të gjithë çelsat dhe prizat te cilat për bënin rrezik për fëmijët. Investimi arriti një vlerë rreth 360.000 lek.

Ky investim i kryer në këto tre shkolla ishte dhe një demonstrim i cili ju dha nxënësve për tju treguar jo vetëm nga ana teorike por dhe nga ana praktike se cilat janë masat që ato duhet të ndërmarrin edhe në shtëpitë e tyre së bashku me prinderit. Përveç sensibilizimit ky investim do të sjellë dhe një faturë mujore 30% më të ulët të energjisë elektrike.

Arion SAUKU

Milieukontakt Shqipëri

Trip Tips: Secluded Albanian bay steeped in legend, full of promise

See link: <http://uk.reuters.com/article/2014/07/31/travel-albania-castle-idUKL5N0OS5UB20140731>

Reuters: “Kalifornia e virgjër” në shqipëri

Klik: <http://www.balkanweb.com/kultur%C3%AB/2691/reuters-kalifornia-e-virgjer-ne-shqiperi-204414.html>

NJOFTIME

- 1- IUCN SEE e-Bulletin – Summer 2014
http://cmsdata.iucn.org/downloads/iucn_see_e_bulletin_38_summer_2014.pdf
- 2- Opportunities of Study in Japan
http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/scholarship_2015.html
- 3- Japanese Government. Scholarship for 2015 (Research student)
http://www.mext.go.jp/a_menu/koutou/ryugaku/boshu/1346643.htm
- 4- Within the frame of the project "Innovative Space Satellite Monitoring of the Environmental Natural Resources of the Cross Border area Greece – Albania", the Biologists of Albania produced the third and last newsletter where you can read the latest news and achievements of the SSMN project:
http://www.ssmnature.eu/files/downloads/3rd_Newsletter_SSMNatuRe.pdf
- 5- Expert – Regional Synthesis Report on the State of Nature Conservation Systems in South-Eastern Europe. IUCN Programme Office for South-Eastern Europe intends to award a service contract for an expert who will contribute to the project "[Towards strengthened conservation planning in SEE](#)" by preparing a Regional Synthesis Report on the State of Nature Conservation Systems in South-Eastern Europe, based on National Assessments of Nature Conservation Systems, prepared by national experts/institutes for nature conservation.
The procurement notice is published on the IUCN SEE website: www.iucn.org/southeasterneurope.
Interested applicants are requested to submit their CV or a company bio and financial offer to see@iucn.org by 22 August 2014 COB.
The vacancy is open to individuals, NGOs and consultancy companies.

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania